

**Konventa “Aarhus”  
Kuptimi, rëndësia dhe aspekte  
të zbatimit të saj në praktikë**

**Prishtinë, Shtator 2006**

Përgatiti:  
Visar Morina

Projekti i financuar nga Ministria e Holandës për Punë të  
Jashtme

## Parathënia

Konventa e Aarhusit paraqet një ndër mekanizmat kryesor të demokracisë në fushën e mjedisit, në vendet që e kanë ratifikuar atë që nga viti 1998. Konventa e Aarhusit, qytetarin e thjeshtë, nga një bartës detyrimesh e bën një partner aktiv në vendimmarrjen për çështjet mjedisore duke ia siguruar atij kështu: të drejtën për të qenë i informuar për situatën mjedisore ku jeton, të drejtën jo vetëm për të marrë pjesë aktive në vendimmarrje për çështje mjedisore, por të ketë edhe të drejtën e qasjes në mbrojtjen ligjore në rast të shkeljes të së drejtës së tij për një mjedis të pastër.

Ky Doracak, publikimi i parë i këtij lloji në Kosovë, u dedikohet zyrtarëve komunal të administratës publike, që në fakt janë shkalla e parë ku qytetari do të drejtohet për zgjidhjen e çështjeve mjedisore, t'i kenë në dorë kornizat e interpretuara të Konventës, si dhe disa udhëzime praktike të formave të komunikimit me qytetarët dhe përgjigjes në nevojat e tyre.

Zbatimi i udhëzimeve të Doracakut, shpresojmë se do të lehtësoj format e komunikimit për të dy palët e procesit: për autoritetet e administratës publike në njërën anë dhe për qytetarin në anën tjetër.

Edhe pse Kosova, formalisht nuk është ende nënshkruese e Konventës, përfshirja e dy nga tri parimet themelore të saj në legjislacionin ekzistues mjedisor i Kosovës, bën që ky Doracak të jetë më se i nevojshëm dhe të lehtësoj zbatimin e këtyre parimeve në praktikë.

Doracaku është rezultat i projektit rajonal “Përmirësimi i Praktikave për Pjesëmarrje Publike - Hapi i ardhshëm në zbatimin e Konventës së Aarhus-it në Shqipëri, në Kosovë, në Bosnje Hercegovinë, në Maqedoni dhe në Serbi e në Mal të Zi” i financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Holandës.

Një falënderim i posaçëm i drejtohet për autorit të këtij Doracakut, Z. Visar Morina, i cili me një zell të përkushtuar, pas një konsultimi të vazhdueshëm të literaturës ekzistuese si dhe praktikave në vendet e rajonit, i solli të thjeshtëzuara dispozitat dhe parimet e Konventës, të përcjella me shembuj konkret se si të zbatohen në praktikë tonë këto dispozita.

Dr. Zeqir Veselaj, drejtor  
REC - Zyra në Kosovë

Prishtinë,  
Shtator 2006

# PËRMBAJTJA

## HYRJE

A. Doracaku - kujt i adresohet? .....	9
B. Konventa e Aarhusit: historiku, organet, ratifikimi dhe tabela e nënshkruesve.....	9
C. Çka rregullon Konventa e Aarhus-it?.....	9
D. Përmbajtja e Konventës.....	10
E. Mekanizmat e Konventës.....	11

## I. ÇËSHTJE TË PËRGGJITHSHME TË PJESËMARRJES SË PUBLIKUT

A. Nocioni i pjesëmarrjes së publikut.....	13
B. Nocioni “autoritet publik” .....	14
C. Akterët e pjesëmarrjes së publikut.....	14
D. Rëndësia e pjesëmarrjes në vendimmarrje.....	15
E. Arsytet e mungesës së pjesëmarrjes në vendimmarrje.....	15

## II. BURIMET E SË DREJTËS SË PJESËMARRJES SË PUBLIKUT

A. Burimet ndërkombëtare.....	17
B. Burimet vendore.....	17

## III. E DREJTA PËR QASJE NË INFORMACIONE MJEDISORE

A. Të kuptuarit e informacionit mjedisor.....	21
B. Informacionet mjedisore që disponohen nga autoritetet publike.....	21
C. Cilat informacione mjedisore shpërndahen nga administrata publik.....	23
D. Qasja në dhëna.....	23
E. Si t’i përgjigjemi kërkesës për informacion mjedisor?.....	24
F. Afati kohor për përgjigje në kërkesë.....	25
G. Refuzimi dhe kufizimi i qasjes në informacionin mjedisor.....	25
H. Vendimi për refuzimin e qasjes ne informacion.....	26
I. Shpenzimet Procedurale.....	26
J. Shpërndarja e informatave publike sipas të drejtës së zbatueshme në Kosovë.....	27
K. Qasja në informacion mjedisor.....	27

## IV. PJESËMARRJA E PUBLIKUT NË VENDIMARRJE

A. Administrata publike - kuptimi.....	29
1. Parimet themelore.....	29
2. Organet e administratës publike në Kosovë.....	30
3. Korniza juridike mbi administratën publike.....	31
B. Çfarë nuk përbën administratë publike?.....	32

C. Detyrimet e autoriteteve publike në lidhje me vendimmarrjen.....	32
D. Roli i administratës publike.....	34
E. Edukimi mjedisor.....	34
F. Standardet minimale.....	34
G. Jo masa ndëshkuese.....	35
H. Pjesëmarrja Publike në kontekst të marrjes së vendimeve për aktivitete të posaçme.....	35
I. Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis (VNM).....	36
J. Pjesëmarrja në hartimin e planeve dhe programeve mjedisore.....	37
K. Pjesëmarrja në hartimin e akteve normative mjedisore.....	38
L. Pjesëmarrja publike në legjislacionin mjedisor të Kosovës.....	38

## V. QASJA NË DREJTËSI

A. E drejta për t’ju drejtuar gjykatës.....	41
B. Përgjegjësia penale për ndotjen e mjedisit.....	41

Shtojcat.....	43
---------------	----

*“Edhe pse për synim ka aspektin rajonal, rëndësia e Konventës së Aarhus- it është globale. Ky është sigurisht elaborimi më mbresëlënës i parimit të 10 - të Deklaratës së Rios, e cila thekson nevojën për pjesëmarrjen e qytetarëve në çështjet mjedisore dhe qasjen në informata mjedisore të mbajtura nga autoritetet publike. Si e tillë, kjo konventë, paraqet hapin më ambicioz në fushën e demokracisë mjedisore, që është ndërmarrë ndonjëherë nën përkrahjen e Kombeve të Bashkuara”*

*Kofi A. Annan,  
Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara<sup>1</sup>*

---

<sup>1</sup> Shih <http://www.unece.org>.

## A. Doracaku - kujt i adresohet?

Ky doracak në radhë të parë i adresohet zyrtarëve publik të përfshirë në dikasteret e mjedisit të nivelit qendror dhe drejtorive lokale, por edhe zyrtarëve që janë të ngarkuar për marrëdhëniet me publikun në të dy nivelet e qeverisjes. Edhe pse Kosova, formalisht nuk është nënshkruese e Konventës së Aarhus-it, në legjislacionin e saj mjedisor janë përfshirë dy nga shtyllat e kësaj Konvente: e drejta e publikut për informim për gjendjen e mjedisit si dhe e drejta për t'ju drejtuar gjykatave në rast cenimi të së drejtës së publikut në mjedis të shëndosh. Për me tepër, doracaku shumë mirë mund të përdoret edhe nga përfaqësuesit e publikut për t'u familjarizuar me detyrimet dhe të drejtat e organeve të administratës publike në raport me kërkesat e Konventës.

## B. Konventa e Aarhusit: historiku, organet, ratifikimi dhe tabela e nënshkruesve

Konventa e Aarhus-it është miratuar në Konferencën e IV Ministrorë të mbajtur, më 23-25 Qershor 1998, në qytezën Aarhus të Danimarkës, nën autoritetin e Komisionit Ekonomik Evropian të Kombeve të Bashkuara (UNECE). Konventa ka hyrë në fuqi, më 30 tetor 2001. Deri tani 20 shtete janë Palë të Konventës.

Qëllimi kryesor i Konventës është të kontribuojë në mbrojtjen e të drejtës së secilit që i takon gjeneratës së tashme, por edhe të ardhme, për të jetuar në një mjedis të shëndetshëm dhe për mirëqenien e saj. Konventa e bënë të përgjegjshëm çdo Palë që të garantojë të drejtën e publikut, për të pasur informacion për mjedisin, për të marrë pjesë në marrjen e vendimeve mjedisore dhe për t'ju drejtuar gjykatës, në lidhje me çështjet mjedisore, në përputhje me klauzolat e kësaj Konvente.

## C. Çka rregullon Konventa e Aarhus-it?

Si akt normativ me karakter ndërkombëtar, Konventa e Aarhus-it vendos një numër të drejtash për publikun (qytetarët dhe asociacionet e tyre) në lidhje me mjedisin. Autoritetet publike (në nivel kombëtar, rajonal ose lokal) duhet të kontribuojnë që këto të drejta të mos mbeten vetëm në rrafshin teorik por të bëhen efektive duke u zbatuar në praktikë. Në përmbajtjen e saj, Konventa rregullon tri fusha kryesore:

- a) Të drejtën e secilit që të marrë informata mjedisore që mbahen nga autoritetet publike. Kjo përfshin informacionet mbi gjendjen e mjedisit, por edhe politikat dhe masat e ndërmarra, ose gjendjen e shëndetit të njerëzve dhe sigurinë kur ajo mund të ndikohet nga gjendja e mjedisit. Qytetarëve iu garantohet që mund të marrin informacionin e kërkuar brenda një muaji pas paraqitjes së kërkesës, pa qenë të detyruar t'i japin arsye se pse e kërkojnë atë informacion. Për më tepër, autoritetet publike, sipas Konventës, janë të përgjegjshëm të ofrojnë qytetarëve informacionin mjedisor me të cilin disponojnë ("qasja në informacionin mjedisor");
- b) Të drejtën për të marrë pjesë në fazat e nismës të procesit të vendimmarrjes për mjedisin. Autoritetet duhet t'i bëjnë të gjitha veprimet e duhura për t'ju mundësuar qytetarëve dhe organizatave mjedisore të ofrojnë komente dhe propozime përkitazi me projektet që trajtojnë mjedisin, planet dhe programet mjedisore, dhe ato komente të merren në konsideratë gjatë procesit të vendimmarrjes ("pjesëmarrja e publikut në vendimmarrjen mjedisore");
- c) Të drejtën e individit t'i drejtohet gjykatave për shkeljen e së drejtës së tij për qasje në informacione mjedisore apo lidhur me vendimet publike që janë marrë pa u respektuar e drejta e pjesëmarrjes publike përcaktuar me nenin 6 të Konventës ("qasja në drejtësi")

## D. Përmbajtja e Konventës

Konventa e Aarhus-it është një dispozitë juridike me karakter ndërkombëtar. Struktura normative e Konventës është si vijon:

Neni 1	Qëllimi
Neni 2	Definicionet
Neni 3	Dispozitat e përgjithshme
Neni 4	Qasja në informatat mjedisore
Neni 5	Mbledhja dhe shpërndarja e informacionit mjedisor
Neni 6	Pjesëmarrja e publikut në vendimet për aktivitete të veçanta
Neni 7	Pjesëmarrja e publikut lidhur me planet, programet dhe politikat që kanë të bëjnë me mjedisin
Neni 8	Pjesëmarrja e publikut gjatë përgatitjes së rregulloreve ekzekutive ose normave të përgjithshme ligjore
Neni 9	Qasja në drejtësi
Neni 10	Takimi i Palëve
Neni 11	E drejta e votës

Neni 12	Sekretariati
Neni 13	Shtojcat
Neni 14	Amendamentet në Konventë
Neni 15	Shqyrtimi i përmbushjes
Neni 16	Zgjidhja e konflikteve
Neni 17	Nënshkrimi
Neni 18	Depozitimi
Neni 19	Ratifikimi, Pranimi, Miratimi dhe Aderimi
Neni 20	Hyrja në fuqi
Neni	Tërheqja
Neni	Teksti autentik
Shtojca I	Lista e aktiviteteve sipas nenit 6 par. 1 (a)
Shtojca II	Arbitrazhi

## **E. Mekanizmat e Konventës**

Trupi qeverisës për Konventën është Takimi i Palëve, organ ky i cili takohet çdo 2-3 vjet për të vlerësuar shkallën e përparimit në ratifikimin e Konventës, jetësimin e saj si dhe të vendos për hapat e ardhshëm nën përkuqjesjen e saj përmes adoptimit të Programit të Punës.

Në periudhën ndërmjet takimeve, Grupet Punuese të palëve përcjellin zbatimin e Programit të Punës. Grupet punuese mbajnë takime vjetore, në zyrën që njëkohësisht shërben edhe për Takimin e Palëve.

Komiteti për Zbatimin e Konventës është themeluar me qëllim të adresimit të problemeve të mospërmbushjes së pretenduar të Konventës së Aarhusit.

Nga takimi i parë i Palëve kanë dal të themeluar 5 Grupe Punuese (Task Force) për t'u marrë me çështje specifike:

1. Grupi Punues për Organizmat e Modifikuar Gjenetikisht OMGJ;
2. Grupi Punues për Lirimin e Ndotësve dhe Transferin e Regjistrave;
3. Grupi Punues për Mjetet Elektronike;
4. Grupi Punues për Qasje në Drejtësi, dhe
5. Grupi Punues për Çështjet Financiare.

# I. ÇËSHËTJE TË PËRGGJITHSHME TË PJESËMARRJES SË PUBLIKUT

## A. Nocioni i pjesëmarrjes së publikut

Pjesëmarrja e publikut në procesin e vendimmarrjes është vitale për demokracinë dhe shtetin e së drejtës. Pjesëmarrja në vendimmarrje krijon një urë komunikimi në mes të autoriteteve publike në një anë dhe qytetarëve në anën tjetër, në çështjet që përfshijnë interesin e përgjithshëm dhe publik. Përmes pjesëmarrjes së publikut në procesin e vendimmarrjes, qytetarëve ju sigurohet e drejta e pjesëmarrjes, të kontrollit dhe monitorimit të aktiviteteve dhe veprimtarive të organeve lokale dhe qendrore në çështjet që ndikojnë në jetën e tyre në kuptimin publik, ekonomik, social, shëndetësor dhe mjedisor. Një interaksion i tillë mundëson shkëmbimin e ideve dhe komenteve që janë relevante për autoritetet publike në procesin e dizajnit të programeve, dokumenteve dhe planeve të natyrës publike.

Nocioni i pjesëmarrjes së publikut nuk nënkupton thjeshtë ofrim të garancive juridike dhe institucionale për pjesëmarrje të publikut në procesin e vendimmarrjes. Kuptimi i saj i plotë dhe efekti i saj praktik kushtëzohet nga niveli i reflektimit dhe inkorporimit të zgjidhjeve të ofruara nga publiku gjatë procesit të vendimmarrjes. Sa më e lartë të jetë shkalla e konsultimit publik dhe inkorporimi i saj në procesin e vendimmarrjes, aq më domethënës dhe kuptimplotë do jetë parimi i pjesëmarrjes të publikut në proceset e vendimmarrjes.

Pjesëmarrja e publikut në procesin e vendimmarrjes ka mbështetje juridike dhe kushtetuese. E drejta në shprehje dhe qasje në informacion i detyron autoritetet publike të fasilitojnë pjesëmarrjen e publikut gjatë procesit të vendimmarrjes. Mjedisi bashkëkohorë i organizuar sipas normave juridike shtron nevojën e informimit dhe konsultimit të gjerë publik në proceset ligjvënëse, normative dhe politikëbërëse përmes ofrimit të mundësive dhe kushteve qytetarëve për pjesëmarrje në proceset e vendimmarrjes. Pjesëmarrja e qytetarëve krijon përgjegjësinë dhe transparencën e autoriteteve publike në procesin e vendimmarrjes dhe fuqizon mbështetjen publike për vendimet që merren.

## B. Nocioni “autoritet publik”

Në pyetjen se çfarë nënkuptohet me "autoritet publik" për qëllime të Konventës së Aarhusit, ajo përkufizon se togfjalëshi autoritet publik nënkupton:

- 1) Qeverinë në nivel kombëtar, rajonal dhe nivel lokal. Në Kosovë këtu përfshihen organet ekzekutive në nivel qendror dhe ato lokale. Pra, jo vetëm qeverinë në kuptim të ngushtë të fjalës por të tërë spektrin e organeve ekzekutive (agjencitë ekzekutive, institutet, departamentet dhe njësitë tjera administrative dhe ekzekutive).
- 2) Personat fizikë ose juridikë që kryejnë funksione publike administrative, sipas ligjit, duke përfshirë dhe detyra, aktivitete ose shërbime të veçanta që kanë të bëjnë me mjedisin. Në këtë kategori bëjnë pjesë, për shembull, ndërmarrjet publike të cilat ushtrojnë një lloj pushteti publik në bazë të autorizimeve publike.
- 3) Çdo person tjetër fizik ose juridik, që ka përgjegjësi ose funksione publike, ose që ofron shërbime publike, në lidhje me mjedisin, nën kontrollin e një organi ose personi, i cili përfshihet në nënparagrafet 1 dhe 2.
- 4) Institucionet e çdo organizate rajonale për integrim ekonomik, referuar në nenin 17, e cila është palë në këtë Konventë;

Duhet theksuar se Konventa përjashton organet legjislativë dhe gjyqësore nga nocioni “autoritet publik” për qëllime të Konventës. Një përjashtim i tillë është i pranuar në të drejtën publike të krahasuar, meqë këto kategori ushtrojnë pushtete të veçanta (ligjberja dhe ndarja e drejtësisë) në kuadrin e pushteteve kushtetuese dhe si të tilla përjashtohen nga kuptimi i autoritetit publik.

## C. Akterët e pjesëmarrjes së publikut

Konventa Aarhus jep një përkufizim të gjerë të nocionit “publiku” për qëllime të vendimmarrjes. Sipas Konventës, me nocionin “publiku” nënkuptohet një ose shumë persona fizikë ose juridikë, në përputhje me legjislacionin e praktikave kombëtare, shoqatat, organizatat dhe grupimet e tyre. Konkretisht, pjesëmarrës në procesin e vendimmarrjes janë qytetarët, shoqatat dhe organizatat jo-qeveritare, asociacionet dhe grupimet e ndryshme sociale që legjitimohen si pjesëmarrjes në procesin e vendimmarrjes.

Konventa, sidoqoftë, nuk përdor kritere përjashtuese në kuptim të legjitimitit të palëve të interesuara. Lloji i akterëve dhe aspekteve të legjitimitit të tyre në kuptim të mundësisë për pjesëmarrje mbeten objekt rregullimi i legjisllacionit vendor dhe praktikave të ndërtuara mbi të.

#### **D. Rëndësia e pjesëmarrjes në vendimmarrje**

Pjesëmarrja e qytetarëve respektivisht e publikut në vendimmarrje për çështjet mjedisore reflektohet në të gjithë pjesëmarrësit në proces. Nga aspekti i propozuesit të një projekti kjo e drejtë i jep legjitimitet propozimit të tij dhe njëherit siguron përkrahjen e publikut të gjerë që nga fazat e hershme të vendimmarrjes. Nga aspekti i marrësit të vendimeve, kjo siguron një proces të hapur dhe të përgjegjshëm të sjelljes së vendimit, si dhe siguron zbatimin e atij vendimi me pajtimin e të gjithë akterëve. Nga aspekti i publikut, pjesëmarrja e publikut siguron mundësinë e ndikimit në procesin e vendimmarrjes, rrit njohuritë për procesin e vendimmarrjes (kush dhe kur vendos) dhe ngrit vetëdijen qytetare për rëndësinë e pjesëmarrjes së publikut në procesin e vendimmarrjes. Kjo, për më tepër, që në procesin e vendimmarrjes, edhe pse konsultohen ekspertët, nuk është e thënë që mendimet e tyre gjithmonë të përputhen me interesat e publikut të gjerë.

#### **E. Arsyet e mungesës së pjesëmarrjes në vendimmarrje**

Tendencat e mungesës së pjesëmarrjes së publikut në procesin e vendimmarrjes janë të ndryshme dhe varen nga pozitat e palëve të interesuara në atë proces. Propozuesi i një projekti, për shembull, detyrohet të pranoj të drejtën e publikut në procesin e vendimmarrjes, nëse një gjë e tillë përcaktohet me ligj. Përndryshe, ai mundohet të evitojë këtë nga frika e zvarritjes si dhe e komplikimeve që mund të shfaqen në procesin e marrjes së vendimit.

Nga ana e vendimmarrësve, tendenca e përjashtimit të publikut në procesin e vendimmarrjes synohet me qëllim të ruajtjes së një lloji “monopoli” për marrjen e vendimit dhe me mungesën e dëshirës që procesin e vendimmarrjes ta ndajnë me të tjerët (përfaqësues të publikut).

Nga aspekti i publikut mungesa e pjesëmarrjes në vendimmarrje neglizhohet shpeshherë me arsyetimin se edhe ashtu

është e vështirë, për të mos thënë e pamundur, të ndikohet në procesin e vendimmarrjes.<sup>2</sup>

<sup>2</sup> Maja Kostic-Mandic, 'Prirucnik za Primjenu Arhuske Konvencije'. (Beograd: REC, 2003) f. 10.



## II. BURIMET E SË DREJTËS SË PJESËMARRJES SË PUBLIKUT

### A. Burimet ndërkombëtare

Miratimit të Konventës Aarhus i kanë pararendë një numër i akteve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, të cilat shprehimisht kanë trajtuar çështjen e pjesëmarrjes së publikut në proceset e vendimmarrjes. Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike i Organizatës së Kombeve të Bashkuara, në nenin 19/2 i garanton secilit të drejtën e kërimit, pranimit dhe shpërndarjes së ideve dhe informatave të secilës natyrë. Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (1950) përcakton se çdo person ka të drejtën e shprehjes. “Kjo e drejtë përfshinë lirinë e opinionit dhe lirinë për të marrë, ose për të dhënë informata apo mendime pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë shtetëror”. Në kuptim të akteve ndërkombëtare të natyrës mjedisore rol të rëndësishëm në hartimin e Konventës Aarhus dhe parimeve të përcaktuara në të kishte Deklarata e Rios për Mjedis dhe Zhvillim (1992) e cila në nenin 10 përcakton nevojën e pjesëmarrjes së qytetarëve në trajtimin e çështjeve mjedisore. Sipas saj, çdo qytetar duhet të ketë qasje adekuate në informacion mjedisor që mbahet nga autoritetet publike dhe mundësinë për pjesëmarrje në proceset vendimmarrëse. “Shtetet duhet të fasilitojnë dhe inkurajojnë vetëdijësimin publik dhe pjesëmarrjen publike duke bërë informacionet mjedisore gjerësisht të arritshme” përcakton Konventa. Nga perspektiva e së Drejtës Evropiane vlen të përmendet Direktiva 2003/4/EC e Parlamentit Evropian dhe Këshillit Evropian (28 Janar 2003) mbi qasjen publike në informata mjedisore (e cila revokoi Direktivën e Këshillit 90/313/EEC) e cila përcakton një sërë garancish juridike për Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian përkitazi me qasjen dhe ushtrimin adekuat të së drejtës për informacion mjedisor.

### B. Burimet vendore

E drejta e aplikueshme në Kosovë ofron një sërë mundësish juridike për realizimin e së drejtës për pjesëmarrje në vendimmarrje publike. Korniza Kushtetuese për Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë (miratuar në vitin 2001) shprehet për zbatimin e instrumenteve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, dhe në këtë drejtim edhe të Konventës

Aarhus<sup>3</sup>. Ndonëse teksti i Kornizës Kushtetuese nuk përmban një kapitull të veçantë mbi të drejtat kushtetuese, ajo bën një referim shprehimor në aktet relevante ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, duke përcaktuar se “institucionet e përkohshme vetëqeverisëse do të respektojnë dhe sigurojnë standardet e pranuar në fushën e të drejtave të njeriut dhe lirive fundamentale, përfshirë këtu edhe të drejtat dhe liritë” të përfshira në instrumentet themelore ndërkombëtare për të drejtat e njeriut<sup>4</sup>. Shikuar nga ky këndvështrim, autoritetet publike në Kosovë, jo vetëm se kanë të drejtë por obligohen të respektojnë instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, përfshirë këtu edhe aktet relevante ndërkombëtare në fushën e qasjes në informata mjedisore. Cilido autoritet publik në Kosovë, qoftë i nivelit lokal apo qendror, detyrohet të respektojë parimet e përcaktuara me të drejtën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, pjesë e së cilës është edhe Konventa Aarhus.

Instrument i rëndësishëm juridik për pjesëmarrje të publikut në proceset e vendimmarrjes në Kosovë është Ligji për Qasje në Dokumente Zyrtare (i miratuar në vitin 2003)<sup>5</sup>. Ky ligj definon parimet, kushtet dhe kufizimet në bazë të interesave publike apo private që kanë të bëjnë me qasjen e dokumenteve të organeve publike<sup>6</sup>. Qëllimi i këtij Ligji është të sigurojë publikimin dhe zbulimin e punës së organeve publike në Kosovë dhe paraqet një bazë të shëndoshë ligjore për fasilitimin e të drejtave individuale për kërkimin e informatave të natyrës publike. Ligji është i gjerë dhe gjithëpërfshirës që do të thotë se mund të shërbejë edhe për realizimin e të drejtave që i përkasin legjislacionit mjedisor, respektivisht qasjes në informata mjedisore. Praktikisht, secili që interesohet për çështjet mjedisore mund të kërkojë

<sup>3</sup> Korniza Kushtetuese për Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë mund të gjendet në internet në adresën <http://www.unmikonline.org>.

<sup>4</sup> Deklarata Universale për të Drejtat e njeriut; (b) Konventa Evropiane për Mbrojtjen e Të Drejtave dhe Lirive Fundamentale të Njeriut dhe Protokollat e saj; (c) Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike dhe Protokollat përkatës; (d) Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimeve Raciste; (e) Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimeve kundër Grave; (f) Konventa për të Drejtat e Fëmijës; (g) Marrëveshja Evropiane për Gjuhët Rajonale apo Minoritare; dhe (h) Konventa Kornizë e Këshillit Evropian për Mbrojtjen e Minoriteteve Nacionale.

<sup>5</sup> Ligji për Qasje në Dokumente Zyrtare, shih faqen elektronike: [www.unmikonline.org](http://www.unmikonline.org).

<sup>6</sup> Pjesa 1 e Ligjit për Qasje në Dokumente Zyrtare.

informacion të dhënë në formë të shkruar apo verbale (dokumente, të dhëna dhe forma tjera komunikimi) nga autoritetet relevante dhe të informohet rreth politikave, vendimeve dhe programeve mjedisore. Ligji ndihmon në përmirësimin e qasjes në informata mjedisore dhe kontribuon në ngritjen e vetëdijesimit mjedisor për të realizuar një pjesëmarrje më efektive të publikut në proceset e vendimmarrjes që përfshijnë mjedisin.

Pjesëmarrja publike është afirmuar edhe në një numër ligjesh vendore në fushën e mjedisit. Kështu, për shembull, pjesëmarrja e publikut në procesin e vendimmarrjes trajtohet në Ligjin për Ujërat e Kosovës (2004) dhe Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës (2005). Ligji për Ujërat e Kosovës ngarkon autoritetet publike që të sigurojnë një pjesëmarrje të qytetarëve në procesin e vendimmarrjes rreth menaxhimit të ujërave dhe resurseve ujore. Parimi i pjesëmarrjes publike është përfshirë në një kontekst më gjithëpërfshirës dhe të përgjithshëm gjë që nënkupton komunikimin aktiv mes autoriteteve publike dhe qytetarëve në procesin e vendimmarrjes sa i përket menaxhimit të ujërave dhe resurseve ujore. Ligji për Ujërat e Kosovës shkon edhe më tutje duke siguruar që dokumentet themelore për planifikimin dhe zhvillimin e menaxhimit ujor po ashtu duhet t'i nënshtrohet diskutimeve publike<sup>7</sup>. Me përjashtim të planit për mbrojtje nga vërshimet, zhvillimi i Planit Strategjik të Ujërave, Plani për Menaxhimin e Ujërave dhe Planet për Menaxhimin e Pellgjeve Lumore kërkojnë përfshirje publike aktive para se të finalizohen. Ligji siguron që secili autoritet i cili propozon planin duhet të informojë publikun tri (3) vite para se të fillojë procesin e hartimit, duke siguruar kështu pjesëmarrje aktive dhe me kohë gjatë hartimit<sup>8</sup>. Para se të fillojë procesi i hartimit, autoritetet relevante duhet të sigurojnë që të gjitha palët relevante qeveritare nga qeveritë lokale dhe qendrore, organizatat jo-qeveritare, mbajtësit e të drejtave ujore, dhe palët tjera të interesuara kanë pasur mundësi të mjaftueshme për të kontribuar në përgatitjen e planit në fjalë. Pasi të ketë përfunduar procesi i hartimit, palët e involvuara do të kenë edhe një mundësi për të dhënë komentet e tyre mbi draftin e përgatitur, në periudhë prej 6 muajsh nga data e shpalljes<sup>9</sup>.

<sup>7</sup> Ligji për Ujërat e Kosovës (Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2004/41), neni 64.

<sup>8</sup> Ibid., para. 2.

<sup>9</sup> Ibid., para. 6.

### III. E DREJTA PËR QASJE NË INFORMACIONE MJEDISORE

#### A. Të kuptuarit e informacionit mjedisor

Konventa nuk e definon togfjalëshin “informacion mjedisor” por kuptimi i tij mund të merret si informacion që i përkasin mjedisit. Sipas Konventës “informatat që i përkasin mjedisit” janë informata që ka të bëjnë me:

- ✓ gjendjen e elementeve të mjedisit jetësor: ajri, uji, toka, diversitetit biologjik si dhe ndërveprimet në mes tyre,
- ✓ faktorët (energja, zhurma, rrezatimi),
- ✓ aktivitetet dhe masat (masat administrative, planet dhe programet, ligjet), analizat ekonomike që shfrytëzohen për sjelljen e vendimeve që kanë të bëjnë me mjedisin, dhe
- ✓ gjendjen e shëndetit dhe sigurisë së njerëzve, kushtet e jetesës si dhe monumenteve të kulturës dhe ndërtesave nëse këto informacione mund të ndikojnë në 2 pikat e lartpërmendura.

Dihet mirë se informatat e përmendura paraqesin vetëm minimumin e kërkesave, ndërsa që secila Palë mund ta zgjerojë spektrin e informacioneve që i përkasin mjedisit. Sipas formës, informacionet mund të jenë në çfarëdo forme materiale: të shkruara, pamore, me zë, elektronike etj.

#### B. Informacionet mjedisore që disponohen nga autoritetet publike

Konventa vendos detyrimet për Palët që të sigurojnë se autoritetet publike në nivel kombëtar të mbledhin, të ruajnë dhe të azhurnojnë informatat që i përkasin mjedisit që janë në fushëveprimin e tyre. Konventa nuk jep udhëzime se në çfarë mënyre duhet të sigurohet kjo, por mënyra më e zakonshme është zhvillimi i sistemit informativ mjedisor, i cili siguron rrjedhjen e informacioneve ndërmjet monitorimit, ekonomisë, hulumtuesve dhe të tjerëve që kanë informacione relevante si dhe autoriteteve publike.

Me Konventë parashihet që të vendoset një sistem i rrjedhjes së informatave në drejtim të administratës publike, e kjo mund të sigurohet në atë mënyrë që organet shtetërore të vendosin parametrat që duhen përcjell, për më tepër që, nga

ndërmarrjet të cilat e bëjnë monitorimin e emisioneve të vetë, të kërkojnë raporte periodike të monitorimit.

Palët Kontraktuese duhet të sigurojnë që regjistrat e ndotësve janë koherent, të kompjuterizuar dhe të paraqesin një bazë të dhënave të hapura në nivel qendror. Informatat nga kjo bazë e të dhënave sigurohen në formë të raporteve standarde mbi kimikatet dhe substancat tjera që përdoren në procesin e prodhimit, emisionet e dëmshme si dhe zhvendosja e substancave prej një vendi në tjetrin me qëllim përdorimi, deponimi apo riciklimi.

#### Shembulli 1<sup>10</sup>

*Z. Genci si mjek i përgjithshëm, ushtron profesionin në një qytet të vogël afër një fabrike kimikatesh. Z. Genci vëzhgon me kujdes gjendjen shëndetësore të pacientëve të tij dhe veçanërisht të fëmijëve. Ai thotë: “Çdo herë unë shoh mundësinë, dhe përpiqem të harxhoj kohë më shumë për të zbuluar lidhjet midis sëmundjeve alergjike në pacientët e mi, fëmijëve në veçanti, dhe ndotjes së shkaktuar nga fabrika e kimikateve aty afër. Veçanërisht shqetësimi im është kur bëhet fjalë për zgjerimin e veprimtarisë së fabrikës. Por, për të arritur ndonjë rezultat në këtë drejtim, kam nevojë të dijë më shumë për natyrën e rrezatimit nga fabrika dhe përqendrimit të tyre. Me fjalë të tjera, kam nevojë për qasje në informacionet e duhura. Shumë herë jam përpjekur të kontaktojë autoritetet lokale, por ata asnjëherë nuk i janë përgjigjur kërkesave të mia ose të shpjegojnë që një informacion i tillë është klasifikuar sipas fabrikës. Për më tepër, në vendin fqinj, në kufi, ndodhet një tjetër fabrikë, aktiviteti i të cilës ka gjithashtu ndikimi në qytetin tonë, veçanërisht kur era fryn në atë drejtim. Me qëllim që të punojë me më saktësi unë gjithashtu kam nevojë për informacion të përditshëm për ndotjen e shkaktuar nga fabrika. Më është thënë, megjithatë, që unë nuk mund të kem një informacion duke u nisur nga fakti që unë isha i huaj. Nuk mund ta kuptoj ç’lidhje kishte kjo me kombësinë, kur ndotja nuk njej kufij.*

<sup>10</sup> Shembulli i poshteshenuar është huazuar nga faqja elektronike [www.milieucontact.nl](http://www.milieucontact.nl).

## C. Cilat informacione mjedisore shpërndahen nga administrate publike

Neni 5/1 i Konventës Aarhus përcakton:

*“në rast të ndonjë kërcënimi të rëndësishëm të shëndetit të njeriut ose mjedisit, shkaktuar nga aktivitetet e njerëzve apo shkaqe natyrore, i gjithë informacioni i cili mund të ndihmojë publikun të marrë masa për të parandaluar ose zbutur dëmin që rrjedh nga ky kërcënim, dhe i cili zotërohet nga një autoritet publik t’u shpërndahet menjëherë dhe pa vonesë anëtarëve të publikut të cilët mund të jenë ndikuar” (Neni 5/1)*

Në raste të rrezikimit të shëndetit të njerëzve dhe mjedisit, pavarësisht nga burimi i rrezikimit, organet e administratës janë të obliguara të njoftojnë publikun me informatat relevante në mënyrë që dëmet eventuale të parandalohen apo të zvogëlohen. Me Konventë parashihet edhe përgatitja dhe publikimi i rregullt i Raportit Kombëtar për gjendjen e mjedisit (në 3-4 vjet).<sup>11</sup>

Palët Kontraktuese janë të detyruara të sigurojnë që në suaza të kuadrit legjislativ dhe praktikave kombëtare, të bëjnë informacionin mjedisor, i cili duhet të jetë transparent, të disponueshëm për publikun, përderisa e drejta për ta pasur informacionin të mund të ushtrohet efektivisht nga publiku.

Palët obligohen që të publikojnë informacionet relevante dhe analizat të cilat janë domethënëse në përgatitjen e politikave për mbrojtjen e mjedisit. Gjithashtu ato obligohen të marrin masa për informimin e publikut sa i përket ligjeve, dokumenteve politike siç janë: strategjitë, planet e veprimt, si dhe të informojnë për implementimin e tyre. Palët, po ashtu, detyrohen të shpërndajnë dhe të bëjnë publike edhe marrëveshjet ndërkombëtare bilaterale dhe multilaterale dhe dokumentet tjera të rëndësishme në lëmin e mjedisit.<sup>12</sup>

## D. Qasja në dhëna

Palët obligohen që të sigurojnë qasje efektive në informatat që kanë të bëjnë me mjedisin. Kushtet dhe parimet e qasjes në informacione mjedisore duhet të jenë të qarta. Në të vërtetë, kjo ka të bëjë me listat, regjistrat dhe data-bazat ku gjenden informatat e mbledhura nga autoritetet publike, si

<sup>11</sup> Kostic-Mandic, (supra note 2) f. 16.

<sup>12</sup> Konventa Aarhus, neni 5.2

dhe informatat që i japin ndërmarrjet ashtu edhe të tjerët. Krahas kësaj, mund të përmbajnë edhe udhëzimet se cilat informata i përmban një dokument i caktuar, si dhe mënyrën se si mund të vihet deri te to. Përveç dokumenteve të shkruara, kohëve të fundit zbatohet edhe forma elektronike e shkëmbimit dhe qasjes në informata. Konventa obligon Palët Kontraktuese të sigurojnë që raportet për gjendjen e mjedisit si dhe ligjet mjedisore të ofrohen në mënyrë elektronike për të siguruar një qasje më të gjerë publike.<sup>13</sup>

## E. Si t’i përgjigjemi kërkesës për informacion mjedisor?

Është shumë e rëndësishme në kontekst të zbatimit të kërkesave që dalin nga Konventa Aarhus se si zyrtarët komunal duhet t’i përgjigjen një kërkesë për informacion mjedisor. Konventa përcakton se autoritetet publike, në përgjigje të kërkesës për informacion mjedisor, duhet t’ ofrojnë informacionin të disponueshëm për qytetarët sa më shpejt që të jetë e mundur, dhe jo më vonë se një muaj pas paraqitjes së kërkesës, nëse volumi dhe kompleksiteti i informacionit e justifikon zgjatjen e kësaj periudhe deri në dy muaj pas depozitimit të kërkesës (Neni 4 para. 1 dhe 2). Konventa e Aarhusit afirmon parimin e barazisë në mes përfaqësuesve të publikut dhe autoriteteve publike kur ata iu drejtohen përfaqësuesve të administratës me kërkesë për qasje në informacion mjedisor (Neni 4).<sup>14</sup>

Konventa nuk e paraqet të nevojshme dhënien e arsyeve nga të interesuarit për qasje në informacion mjedisor. Për më tepër, autoritetet publike duhet të sigurojnë informacionin mjedisor në formën e kërkuar nga kërkuesi, përveç nëse nuk është e arsyeshme për autoritetet publike që ta bëjnë atë të disponueshëm në formën e kërkuar (dhe në këtë rast duhet të jepen arsyet përse e kanë bërë të disponueshëm në formën përkatëse) apo nëse një formë e tillë e dokumentit nuk është e disponueshme nga autoritetet publike.

<sup>13</sup> Kostic-Mandic, (supra note 2) f. 17.

<sup>14</sup> Ibid. f. 17.

## Shembulli 1:

5 Maj 2006

I/e nderuar,

### KËRKESË PËR QASJE NË INFORMACION

Në bazë të Ligjit për Mjedisin Nr. \_\_\_\_\_ Neni \_\_\_\_\_ dhe Ligjin për Qasje në Dokumente Zyrtare Nr. \_\_\_\_\_ Neni \_\_\_\_\_ kërkoj të më ofroni kopjen e vendimit mbi \_\_\_\_\_ Nr. \_\_\_\_\_ të datës \_\_\_\_\_ lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Ju lutem, nëse shuma e bërjes publike të dokumentit është me e lartë se 10 Euro, më notifikoni paraprakisht për të.

Sipas Nenit \_\_\_\_\_ të Konventës Aarhus (i cili është një instrument i zbatueshëm në Kosovë), presim një përgjigje të shpejtë nga autoriteti i sipërpërmendur por jo më vonë se 10 Qershor 2006.

Ju lutem na notifikoni për pranimin e kërkesës.

Me respekt,

\_\_\_\_\_  
Emri, Mbiemri

## F. Afati kohor për përgjigje në kërkesë

Sa i përket afatit kohor për përgjigje në kërkesë, Konventa niset nga parimi juridik se informacioni mjedisor duhet të bëhet i disponueshëm "sa më shpejt që të jetë e mundur" por jo më vonë se një muaj pas paraqitjes së kërkesës (Neni 4, para. 2). Përjashtimisht, kur kompleksiteti i informatave të kërkuara e justifikon zgjatjen e këtij afati kohor, organi i administratës është i obliguar të sigurojë qasjen në informacion mjedisor në afatin prej dy muaj pas parashtrimit të kërkesës.

## G. Refuzimi dhe kufizimi i qasjes në informacionin mjedisor

Konventa përcakton dy kategori rrethanash për refuzimin e një kërkesë për qasje në informacion mjedisor:

a) rrethanat teknike - në rast se organi i administratës nuk e posedon informatën e kërkuar. Kjo rrethanë nuk e liron

atë nga obligimi ndaj palës që bën kërkesë. Organi i administratës është i obliguar që në afatin sa më të shkurtër të njoftojë atë se cili organ posedon informatën e kërkuar ose në rastin tjetër më të mirë të përcjell kërkesën tek organi kompetent dhe për këtë të njoftojë palën; në rast se kërkesa është paraqitur në mënyrë tepër të paarsyeshme ose është formuluar në një mënyrë shumë të përgjithshme, apo nëse kërkesa ka të bëjë me një material që është në përfundim ose ka të bëjë me komunikimin e brendshëm të autoriteteve publike.

b) rrethanat juridike dhe kufizimet e legjituara - një kërkesë për informacion mjedisor mund të refuzohet në qoftë se dhënia e tij cenon konfidencialitetin e të dhënave, mund të cenojë mbrojtjen kombëtare apo sigurinë publike, kur cenon të drejtën e privatësisë lidhur me të dhënat personale dhe/ose dosjeve të personit fizik, kur ky person nuk ka dhënë pëlqimin e tij për dhënien e informacionit për publikun apo nëse cenon konfidencialitetin e informacionit tregtar dhe industrial (përfshirë edhe të drejtat për pronën intelektuale) në rast se një konfidencialitet i tillë mbrohet me ligj, me qëllim që të mbrohet një interes legjitim ekonomik.

## H. Vendimi për refuzimin e qasjes në informacion

Një vendim i autoriteteve publike për refuzimin e qasjes në informacion duhet të përmbajë këto elemente:

- ✓ Të jepet në formë të shkruar.
- ✓ Të jepet në një afat sa më të shkurtër.
- ✓ Të përmbajë bazën juridike për refuzim.
- ✓ Të specifikojë natyrën e të dhënave, bërja publike mbi bazën e të cilave është bërë refuzimi i kërkesës.

## I. Shpenzimet Procedurale

Autoritetet publike mund të vendosin një taksë të arsyeshme dhe të përballueshme për procedimin e kërkesës për dhënien e informacionit mjedisor. Shuma dhe mënyra e pagesës duhet t'i bëhen të ditura paraprakisht parashtruesit të kërkesës.<sup>15</sup>

<sup>15</sup> Ibid., f. 19.

## J. Shpërndarja e informatave publike sipas të drejtës së zbatueshme në Kosovë

Sipas Ligjit për Qasje në Dokumentet Zyrtare (Rregullorja Nr. 2003/32, datë 06 Nëntor 2003), “cilido...ka të drejtë në qasje të dokumenteve të institucioneve duke iu nënshtruar parimeve, kushteve dhe kufizimeve të përkufizuara me këtë ligj (Neni 3.1.)” Kërkesat për qasjen në dokumente parashtrihen në formë të shkruar (përfshirë edhe formën elektronike) duke identifikuar qartë dokumentin që kërkohet. Sipas Ligjit, parashtruesi i kërkesës nuk është i detyruar t’i jap arsyet për parashtrimin e kërkesës (Neni 5.1). Ligji parashih që procedura për trajtimin e kërkesës për qasje në dokumente të realizohet me procedurë të shpejtë. Së pari, parashtruesit notifikohet me shkrim për kërkesën e pranuar kurse organi përkatës vendos mbi kërkesë për qasje në informacion brenda 15 ditëve të punës prej kohës së regjistrimit të kërkesës. Autoriteti publik ofron përgjigje me shkrim për lejimin apo kufizimin e qasjes në informacion duke dhënë arsyet për refuzimin e plotë apo të pjesërishtë të kërkesës për informacion mjedisor.

Qasja në informacione zyrtare mund të kufizohet nëse konstatohet se bërja publike e informacionit mund të rrezikojë mbrojtjen e interesit publik lidhur me:

- ✓ *sigurinë publike*
- ✓ *mbrojtjen e qytetarëve*
- ✓ *bashkëpunimin ndërkombëtar*
- ✓ *politikën financiare apo ekonomike të IPVQ-ve*
- ✓ *jetën private dhe ndershmërinë e individit, veçanërisht në pajtim me ligjin në fuqi që ka të bëjë me mbrojtjen e të dhënave personale (Neni 4.1)*

Ligji po ashtu përcakton se “institucionet krijojnë praktika të mira administrative për ta lehtësuar ushtrimin e së drejtës për qasje të cilën e garanton ky ligj” (Neni 14.1).

## K. Qasja në informacion mjedisor

E drejta e publikut për informim garantohet me Ligjin e Mjedisit (Rregullorja Nr. 2003/9). Në pjesën mbi parimet themelore ky Ligj përcakton:

**(Parimi i qasjes publike në informata)** ”të gjithë personat kanë në përgjithësi të drejtë të jenë të informuar për gjendjen e mjedisit. Informatat që kanë të bëjnë me gjendjen e mjedisit dhe informatat tjera të lidhura me mjedisin për procedurat dhe aktivitetet e autoriteteve publike dhe shërbi-meve vepruese të autoriteteve publike që bëjnë shërbimet

publike në fushën e mbrojtjes të mjedisit, deri në masën e kërkuar me Ligjin për Lirinë e Informatave, do të mundësojnë ofrimin e informacionit publik dhe do t’i ofrojnë publikut qasje në informata”.

Më tutje, neni 35 paragrafi 3 definon se “të dhënat e grumbulluara nga monitorimi i gjendjes së mjedisit përbëjnë informacion publik dhe përfshihen në Sistemin Informativ të mbrojtjes së mjedisit. Këto të dhëna publikut i bëhen të njohura nëpërmjet mediave publike ose formave tjera të informimit publik”.

Për më tepër, edhe *Ligji për Mbeturina* (Rreg. Nr. 2006/31 datë 05 Maj 2006) i referohet qartë dhe drejtpërdrejt Konventës së Aarhus-it sa i përket qasjes në informacion. Neni 5 para. 8 (parimi për qasje të publikut në informacione) siguron që të gjithë personat natyror dhe juridik kanë të drejtën, pa pasur nevojë të dëshmojnë një interes special, të kenë qasje në të gjitha informatat që kanë të bëjnë me aktivitetet për menaxhimin e mbeturinave “në pajtim me parimet e Konventës së Aarhus-it”. Përderisa Ligji nuk përmban një kapitull të veçantë për qasjen në informata, afirmimi i parimit për qasje në informata duke ju referuar në mënyrë eksplicite Konventës së Aarhus-it ofron një instrument të përshtatshëm i cili siguron kornizë të mjaftueshme normative për transparencë në aktivitetet e krijimit të politikave dhe vendim-marrjes në menaxhimin e mbeturinave, si dhe qasje të sigurt në të dhënat për aktivitetet dhe autoritetet e menaxhimit të mbeturinave. Ligji përcakton qartë standardet e Aarhus-it për qasje në informata të cilat duhet të përcillen nga autoritetet vis-à-vis personave natyrorë dhe juridik.

## IV. PJESËMARRJA E PUBLIKUT NË VENDIMMARRJE

Konventa Aarhus në nenin 6, 7 dhe 8, trajton detyrimet e autoriteteve publike për pjesëmarrjen së publikut në procesin vendimmarrjes për çështje të mjedisit. Përgjithësisht, Konventa vendos një sërë detyrimesh për autoritetet përkitazi me pjesëmarrjen në procesin e vendimmarrjes. Konventa, po ashtu përcakton një sërë rregullash lidhur me pjesëmarrjen në procesin e hartimit të akteve normative dhe rreth aktiviteteve të veçanta mjedisore. Parakusht themelor për zbatimin efektiv të këtij koncepti është që pjesëmarrja e publikut të sigurohet që nga fillimi i procesit vendimmarrjes, kur të gjitha mundësitë janë të hapura dhe kjo siguron një ndikim përmbajtësor në marrjen e vendimeve. Kjo, për t'u bërë e mundshme, është e domosdoshme që në nivel vendi të sigurohen parakushtet nga aspekti i legjislacionit dhe atij institucional që publiku të jetë i përfshirë në vendimmarrje.<sup>16</sup>

### A. Administrata publike - kuptimi

Më lartë e kemi përshkruar se çfarë kuptohet me termin “autoritet publik” në qëllime të Konventës. Në kuptim të përgjithshëm, togfjalëshi “administratë publike” nënkupton tërësinë e organeve administrative të cilat ushtrojnë shërbime publike. Sot në të drejtën administrative gjithnjë e më tepër gjen referim termi administratë publike për dallim nga administrata shtetërore, për faktin se një pjesë e madhe e pushtetit administrativ konsiston në ushtrimin e funksioneve dhe shërbimeve publike. Me një fjalë, togfjalëshi “administratë publike” është shumë më i gjerë se sa nocioni ai administratës shtetërore sepse përfshinë administratën shtetërore dhe veprimtaritë e institucioneve të cilat ushtrojnë punë të karakterit publik”.

#### 1. Parimet themelore

Sipas Ligjit për Procedurën Administrative (Rreg. Nr. 2006/33, datë 13 Maj 2006) veprimtaria e përgjithshme e administratës publike mbështetet në disa parime themelore, siç janë:

<sup>16</sup> Shih <http://www.tearce.gov.mk/shq>.

**parimi i ligjshmërisë** (tërë aktiviteti i organeve të administratës publike mbështetet në ligj);

**parimi i balancimit të interesave publike dhe private** (organet e administratës publike, në ushtrim të veprimtarisë administrative, duhet të vendosin një balancim të drejtë mes interesave publike dhe interesave private të përfshira në të, në mënyrë që të evitohen ndërhyrjet e panevojshme në të drejtat dhe interesat e personave fizikë dhe juridikë);

**parimi i barazisë para ligjit** (organet e administratës publike nuk bëjnë dallimet lidhur me personat fizikë dhe juridikë si: gjini, racë, ngjyrë, gjuhë, opinion politik ose opinion tjetër, origjinë kombëtare ose sociale, pasuri, lindje ose ndonjë status tjetër, gjatë veprimtarisë administrative);

**parimi i proporcionalitetit** (gjatë ushtrimit të kompetencave të tyre ligjore në zbatim të interesit publik, organet e administratës publike do të përdorin mjetet që janë në proporcion me qëllimet që synohen të arrihen);

**parimi i dyshkallshmërisë** (e drejta e palës që të atakoj vendimet e shkallës së parë)

**parimi i efektivitetit** (detyrimi i organeve të administratës publike që çështjet administrative të vendosen në afatin më të shpejtë të mundur);

**parimi i transparencës publike** (në veprimtarinë e tyre organet e administratës publike udhëhiqen nga një politikë transparente);

**parimi i pjesëmarrjes së publikut në politikat publike** (organet e administratës publike duhet të inkurajojnë pjesëmarrjen publike në hartimin e politikave publike);

#### 2. Organet e administratës publike në Kosovë

Administrata publike në Kosovë është e organizuar në dy nivele.

- a) niveli qendror që përfshin autoritetet publike në nivelin qendror (përfshirë institucionet e UNMIK-ut dhe Institucionet qendrore të IPVQ-ve).
- b) niveli lokal - i cili përfshin organizimin dhe ushtrimin e autoritetit publik në nivelin komunal.

Sipas Rregullores së UNMIK Nr. 2000/45 (11 Gusht 2000) mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës, “njësia themelore territoriale e vetëqeverisjes lokale në Kosovë është komuna, e cila ushtron tërë pushtetin, i cili nuk është i rezervuar shprehimisht për Pushtetin Qendror (Neni 2.1.)” Sipas Nenit 2.2. të Rregullores, “komunat rregullojnë dhe udhëheqin çështjet publike në territorin e tyre brenda kufijve të përcaktuar me ligj, për të siguruar kushte për jetë normale dhe të qetë për të gjithë banorët e Kosovës. Ato mund të kujdesën për çështje me interes të përgjithshëm që kanë të bëjnë me komunën dhe të cilat nuk i përkasin vetëm Pushtetit Qendror apo ndonjë organi tjetër.” Komunat nxjerrin rregullore lokale të komunës që i përkasin çështjeve përbrenda kompetencave të komunës. Statuti i komunës duhet të mundësojë kushte për miratimin dhe publikimin e tyre pas konsultimit publik (Neni 4).

Në Kosovë tanimë vepron Instituti i Kosovës për Administratë Publike si agjenci ekzekutive në kuadër të Ministrisë së Shërbimeve Publike (Urdhëresa Administrative e PSSP-së nr. 2003/25) për të mbështetur shërbimin civil në Kosovë, në nivel lokal dhe qendror përmes trajnimeve dhe programeve në fushën e administratës publike.<sup>17</sup>

### 3. Korniza juridike mbi administratën publike

Në Kosovë nuk ekziston një ligj i veçantë që rregullon fushën e administratës publike. Aspekte të administratës publike rregullohen me ligje të veçanta që trajtojnë çështje të caktuara të administratës publike. Në këtë drejtim, për shembull, çështjet e shërbimit civil rregullohen me Rregulloren e UNMIK-ut 2001/36 mbi Shërbimin Civil në Kosovë. Aspekte të procedurës administrative rregullohen me Ligjin për Procedurën Administrative (Rreg. Nr. 2006/33, datë 13 Maj 2006). Kurse çështjet e qasjes në dokumentet zyrtare trajtohen me Rregulloren 32/2003 për promulgimin e Ligjit për Qasjen në Dokumente Zyrtare (03 Nëntor 2003). Ky i fundit definon parimet, kushtet dhe kufizimet lidhur me qasjen në dokumente zyrtare të IPVQ-ve, organeve komunale, organeve të pavarura si dhe Agjencionit Kosovar të Mirëbesimit.<sup>18</sup>

<sup>17</sup> Për strukturën dhe mandatin e Institutit Kosovar të Administratës Publike, shih <http://www.ikap.org>

<sup>18</sup> Ligji për Qasjen në Dokumente Zyrtare është i shkarkueshëm në faqen vijuese elektronike: <http://www.unmikonline.org>

## B. Çfarë nuk përbën administratë publike?

Ekzistojnë një numër faktorësh që ndajnë administratën publike nga ajo private. Në këtë kuptim, në literaturën amerikane “dallimi ndërmjet administratës publike dhe asaj private shprehet në karakterin e tyre, sepse administrata publike konsiderohet politike ndërsa ajo private është e zhveshur nga politika”.<sup>19</sup> Ekziston edhe një pikëpamje sipas së cilës administratë private konsiderohet tërë ajo që nuk bën pjesë në administratën publike. Për shembull, ndërmarrjet private, korporatat dhe kompanitë private, organizatat tregtare etj. nuk bëjnë pjesë në konceptin e administratës publike. Forma të tilla të organizatave nuk janë të pajisura me autorizime për të ushtruar funksione dhe autoritete publike andaj nuk hyjnë në kuadrin e administratës publike.

## C. Detyrimet e autoriteteve publike në lidhje me vendimmarrjen

Në procesin e informimit të publikut të interesuar përmes lajmërimit publik ose individual, Konventa detyron Palët të sigurojnë që publiku të jetë në kohë i informuar, inter alia edhe për:

- Aktivitetin e propozuar dhe aplikacionin mbi të cilën do të merret një vendim;
- Natyrën e vendimeve të mundshme ose draftin e vendimit;
- Autoritetin publik, përgjegjës për marrjen e vendimit;
- Procedurën e parashikuar, e kur ka mundësi edhe informimi për: fillimin e procedurës, mundësinë e pjesëmarrjes së publikut; kohën dhe vendin e çdo mbledhje publike, të parashikuar; adresimin tek autoriteti publik, prej të cilit mund të merret informacioni përkatës dhe ku ky informacioni depozitohet për shqyrtim nga publiku dhe adresimin tek autoriteti publik ose çdo organ tjetër zyrtar, të cilit mund t’i drejtohen komente ose pyetje, si edhe informimi për kohën ose afatet kohore të paraqitjes së këtyre pyetjeve apo komenteve;
- Faktin që aktiviteti i nënshtrohet një procedure kombëtare apo ndërkufitare të vlerësimit të ndikimit në mjedis.

<sup>19</sup> <http://www.tearce.gov.mk>.



*Familja e Gencit ka në zotërim disa toka në afërsi të një linje të rëndësishme transporti. Ata kanë ndërmend të zhvillojnë atje një blegtori shumë efikase dhe të frytshme, por disa ndryshime në mjedis, ngrenë disa dyshime serioze tek ata. Ja çfarë thotë Z. Genc: “Jam shumë i shqetësuar nga numri dhe shpejtësia e ndërtimeve kohët e fundit. Ka mbetur shumë pak nga rruga e rehatshme dhe e qetë e fshatit. Tani po planifikohet të ndërtohet një autostradë. Kjo do të çojë në rritjen e trafikut dhe prej këtu – në nivelet e larta të zhurmës dhe ndotjes. Kjo do të ketë një ndikim negativ në prodhimtarinë e bagëtive të mia.” “Planet për ndërtimin e një linje transmetimi të fuqishme janë gjithashtu shumë alarmante – shton Z. Genc. Kam dëgjuar së elektriciteti dhe valët magnetike kanë një ndikim negativ në shëndetin e njerëzve dhe të kafshëve dhe bile pengojnë rritjen normale të bimëve. Çfarë do i ndodhë biznesit tonë, atëherë?”<sup>20</sup>*

Qasja efektive në informata është një ndër parakushtet themelore për pjesëmarrje efektive të publikut në procesin e vendimmarrjes. Në këtë drejtim Konventa kërkon nga Palët që të sigurojnë një qasje të lirë në informacione në pajtim me legjislacionin duke paraparë informatat minimale të mundshme që përfshijnë:

- një përshkrim të vendit dhe karakteristikave fizike e teknike të aktivitetit të propozuar;
- përshkrimin e ndikimeve të aktivitetit në mjedis;
- përshkrimin e masave të parapara për evitimin respektivisht zvogëlimin e atyre ndikimeve në formë rezymeje të kuptueshme edhe për qytetarët e thjeshtë;
- një përmbledhje të alternativave kryesore të studiuara nga parashtruesi i kërkesës;
- raportet dhe sugjerimet kryesore të dërguara përfaqësuesve të publikut pas informimit të tyre për fillimin e procedurës.<sup>21</sup>

### D. Roli i administratës publike

Konventa përcakton që Palët Kontraktuese të sigurojnë që përfaqësuesit e administratës shtetërore të japin udhëzimet e duhura publikut për t'i mundësuar realizimin e të drejtave të

<sup>20</sup> Shembulli i sipërmendur është huazuar nga faqja elektronike [www.milieukontakt.nl](http://www.milieukontakt.nl)

<sup>21</sup> Kostic-Mandic, (supra note 2) f. 27.

veta: të drejtën për informim, pjesëmarrje në vendimmarrje dhe qasje në sistemin e drejtësisë (Neni 3/2). Në kushtet bashkëkohore, një nga format më të lehta padyshim është interneti dhe format tjera të komunikimit masiv elektronik. Në Kosovë, sidoqoftë, kjo formë e komunikimit ndodhet në fazat e zhvillimit.

Në rastet më të mira duhet bërë përpjekje që zyrtarët që mund të jenë të ndërlidhur drejtpërdrejt me kërkesa të Konventës së Aarhus-it, të posedojnë njohuritë themelore për Konventën.

### E. Edukimi mjedisor

Palët nënshkruese të Konventës marrin përgjegjësi që të rrisin shkallën e edukimit dhe vetëdijesimit të popullatës për të drejtën e tyre për informim dhe vendimmarrje në çështjet mjedisore. Konventa, në këtë mënyrë, edukimin dhe ngritjen e vetëdijes së popullatës për informim dhe vendimmarrje e vendos në nivelin e obligimeve ndërkombëtare. Sidoqoftë, mënyra se si shtetet anëtare të Aarhus-it e zbatojnë këtë detyrim, përfshirë format e realizimit, mbetet çështje e Palëve Kontraktuese.

Ngritja e vetëdijes për çështjet e mjedisit duhet të fillojë qysh në nivelin parashkollor, ndërsa që nevoja e ruajtjes së mjedisit duhet të shoqërohet në të gjitha fazat tjera të arsimit. Individit i arsimuar në këtë mënyrë do të jetë më i përgjegjshëm në relacion me mjedisin dhe do të pajiset me njohuritë themelore për detyrimet qytetare ndaj mjedisit si dhe të drejtat e tij në lidhje me informimin dhe procesin e vendimmarrjes në zgjidhjen e problemeve mjedisore.

Përveç kësaj, Palët Kontraktuese marrin detyrime të përcaktojnë masa për njohjen e duhur dhe mbështetjen e shoqatave, organizatave, ose grupeve që promovojnë mbrojtjen e mjedisit dhe të sigurojnë që sistemi juridik të jetë në përputhje me këtë detyrim që përcakton Konventa (Neni 3/4).

### F. Standardet minimale

Konventa vendos standardet minimale për Palët Kontraktuese sepse disa nga ato mund të kenë standarde juridike të pjesëmarrjes së publikut më të avancuara se sa që përcakton vetë Konventa. Me këtë, Konventa vendos standardet themelore (minimale) nën të cilat nuk mund të lejohet, e Palët mund të ndërmarrin masa të cilat sigurojnë përfshirjen cilësore dhe të gjithëmbarshme të pjesëmarrjes së publikut në informim, vendimmarrje dhe qasje në gjykata. Në këtë

mënyrë, aktet normative të Palëve Kontraktuese për pjesëmarrjen e publikut konsiderohen të jenë në pajtueshmëri me Konventën për aq sa përcaktojnë zgjedhje të njëjtë (ose më të avancuar) me standardet minimale të përcaktuara me Konventë kur ka të bëjë me informimin, pjesëmarrjen në vendimmarrje dhe qasjen në drejtësi.

## G. Jo masa ndëshkuese

Palët Kontraktuese do të sigurojnë që personat të cilët ushtrojnë të drejtat e tyre në përputhje me rregullat e Konventës nuk do të gjykojnë, persekutohen ose ngacmohen në çfarëdo mënyre për veprimet e tyre. Në masa represive bëjnë pjesë: dënimi, ndjekja gjyqësore ose kërcënimi në cilëndo formë qoftë, të motivuar nga zbatimi efektiv i konceptit të pjesëmarrjes së publikut.

## H. Pjesëmarrja Publike në kontekst të marrjes së vendimeve për aktivitete të posaçme

Konventa Aarhus përcakton listën e aktiviteteve për të cilat pjesëmarrja publike është e domosdoshme. Vendimet administrative kanë të bëjnë me nivele të ndryshme të vendimmarrjes si: planifikimi urban; lejet e ndërtimit; vendimet për nivelin e emisioneve etj. Autoritetet publike janë të detyruara të informojnë publikun e interesuar qoftë përmes lajmërimit publik ose individualisht në procedurën e hershme të marrjes së një vendimi për mjedisin, dhe në një mënyrë të pranueshme, efektive dhe në kohë. Sipas Konventës, procedurat për pjesëmarrjen e publikut duhet t'i mundësojnë publikut të paraqesë, në një mbledhje publike ose shqyrtim të zhvilluesit, çdo koment, informacion, analizë ose opinion, që konsiderohet i dobishëm për aktivitetin e propozuar (Neni 6.7). Autoritetet publike duhet të sigurojnë që në marrjen e vendimit për aktivitetin e propozuar rezultatet e pjesëmarrjes së publikut të merren parasysh dhe publiku të informohet me kohë për rezultatet e vendimmarrjes. Po ashtu është e rëndësishme që autoritetet publike të përgatisin procesverbalin e mbledhjes dhe të njëjtin të bëjnë të arritshëm për palët e përfshira në proces, si dhe të notifikohen për rezultatet e vendimit.

Listat e dhëna në Shtojcën e Konventës përfshijnë dhënien e pëlqimit gjegjësisht lejeve për rreth 20 sektorë ku bëjnë pjesë:

- ✓ sektori energjetik
- ✓ prodhimi dhe përpunimi i metaleve
- ✓ industria minerale

- ✓ industria kimike
- ✓ menaxhimi i mbeturinave
- ✓ impiantet për trajtimin e ujërave të zeza
- ✓ impiantet e caktuara industriale
- ✓ hekurudhat dhe aeroportet
- ✓ rrugët ujore dhe portet
- ✓ sistemet për mbledhjen e ujërave nëntokësore
- ✓ punët në transportin e ujërave
- ✓ nxjerrja e naftës dhe gazit natyror
- ✓ digat
- ✓ gypat
- ✓ fermat e shtazëve
- ✓ minierat dhe mihjet sipërfaqësore
- ✓ ndërtimi i largpërçuesve
- ✓ impiantet për deponimin e karburanteve etj.

Pjesëmarrja e publikut gjithashtu është e nevojshme edhe në procedurën e ndërrimit ose zgjerimit të aktiviteteve. Duhet theksuar se pjesëmarrja e publikut nuk është vetëm për marrjen e lejeve të aktiviteteve të përfshira në Shtojcë, nëse ka për qëllim hulumtimin, testimin dhe zhvillimin e prodhimeve të reja për periudhë më pak se dy vite, përveç nëse aktivitetet e tilla me siguri do të shkaktonin dëme në mjedis. Pjesëmarrja e publikut në bazë të ligjeve gjithashtu mund të kufizohet në rastet kur mund të cenohet siguria kombëtare.<sup>22</sup>

## I. Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis (VNM)

Konventa nuk përcakton një procedurë të veçantë për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (VNM). Sidoqoftë, një procedurë VNM siguron që efektet mjedisore të projekteve të identifikohen dhe të vlerësohen para se të jepet një vendim për to. Publiku ka të drejtë të jap komente dhe të ofroj sugjerime përkritazi me projektin e propozuar dhe rezultatet e një procedure të tillë, që duhet të merren parasysh në procesin e dhënies së lejës së VNM-së. Në shumë shtete, ligji përcakton kategoritë e projekteve për të cilat kërkohet VNM-ja, procedura që duhet ndjekur si dhe përmbajtja e vlerësimit.

*Aspekte të VNM-së në nivel të së drejtës evropiane rregullohen me Direktivën (27 Qershor 1985) Nr. 85/337 për vlerësimin e efekteve mjedisore të disa projekteve private dhe publike. Direktiva është amendamentuar në vitin 1997 dhe 2003.*

<sup>22</sup> Ibid., f. 24

Në Kosovë aspektet procedurale të lëshimit të një pëlqimi mjedisor apo lejeve mjedisore për vlerësimin e ndikimeve mjedisore të një projekti të propozuar (për projekte për të cilat kërkohet VNM) rregullohen me Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit (Rregullorja 2003/09) dhe Udhëzimin administrativ Nr. 09/2004.

Në kontekst të pjesëmarrjes publike dhe kërkesave të Konventës Aarhus, është me rëndësi të theksohet se Udhëzimi Administrativ 9/2005 përcakton mbajtjen e konsultimeve publike për shqyrtimin e konkludimeve dhe rekomandimeve kryesore në raportin mbi VNM.

Sipas nenit 14, aplikuesi është i detyruar të:

*Të informojë publikun, nëpërmes mjeteve të informimit, ku përfshihet shpallja më së paku në një gazetë ditore kombëtare dhe në një lokale, dhe këtë tri herë gjatë një jave, se përmbledhja jo-teknike dhe drafti i vendimit janë të gatshme si dhe vendin dhe datat ku mund të bëhet kontrollimi i tyre.*

*Njoftimi (njoftimet) publik duhet të informojë publikun se komentet e shkruara mund të dërgohen drejtpërdrejt në AKM dhe në këtë rast të shënohet adresa dhe afati për dorëzimin e shkresës në AKM-së*

*Të sigurojë kopje të përmbledhjes jo-teknike të raportit të VNM-së si dhe të draftit të vendimit, për zyrat lokale të Ministrisë, për komunën, shkollat dhe bashkësitë lokale ashtu që publiku i gjerë të ketë kopje të mjaftueshme për të konsultuar.*

*T'i sigurojë AKM-në, në afat prej 5 ditësh nga shpallja, kopje të të gjitha shpalljeve si dëshmi nga aplikanti për publikimin e tyre në mjetet e informimit në një datë të caktuar.*

## **J. Pjesëmarrja në hartimin e planeve dhe programeve mjedisore**

Konventa obligon çdo Palë që të krijojë kushte të përshtatshme praktike për pjesëmarrjen e publikut gjatë përgatitjes së planeve dhe programeve mjedisore brenda një kuadri transparent dhe të korrekt duke i siguruar informacionin e nevojshëm paraprakisht. Publiku i cili mund të marrë pjesë, do të identifikohet nga autoriteti përkatës publik duke marrë parasysh objektivat e kësaj Konvente. Duhet theksuar se në nivel evropian çështjet e pjesëmarrjes së publikut në

hartimin e planeve dhe programeve mjedisore rregullohen me Direktivën Nr. 2001/42/EC, të miratuar, më 27 Qershor 2001, për vlerësimin e efekteve të disa planeve dhe programeve mjedisore. Kjo Direktivë synon arritjen e një shkallë më të lartë të mbrojtjes së mjedisit dhe integritetit të shqetësimeve mjedisore në hartimin dhe miratimin e planeve dhe programeve mjedisore duke kërkuar realizimin e një vlerësimi mjedisor për plane dhe programe të caktuara që mund të prodhojnë efekte serioze për mjedisin.<sup>23</sup>

## **K. Pjesëmarrja në hartimin e akteve normative mjedisore**

Qëllimi kryesor i Nenit 8 të Konventës është që Palët Kontraktuese të promovojnë në mënyrë efektive pjesëmarrjen e publikut në procedurën e hartimit dhe nxjerrjes së akteve të rëndësishme normative mjedisore. Për këtë qëllim, Konventa përcakton që autoritetet e Palëve Kontraktuese duhet të caktojnë afatet kohore të mjaftueshme për pjesëmarrje efektive; të publikojnë (ose të mundësohet qasja e publikut) draft rregullat juridike dhe duhet t'i japin publikut mundësi të konsiderueshme që ato draft rregulla juridike t'i komentojnë drejtpërdrejt ose nëpërmjet organeve përfaqësuese këshillimore. Në draft rregulla juridike përfshihen ligjet dhe aktet nënligjore që trajtojnë çështje mjedisore.

## **L. Pjesëmarrja publike në legjislacionin mjedisor të Kosovës**

E drejta e aplikueshme në Kosovë parashih pjesëmarrjen e publikut në procesin e vendimmarrjes dhe detyrimin e autoriteteve publike për të marrë parasysh rezultatet e pjesëmarrjes së publikut. Kështu, për shembull, e drejta e qytetarëve për të marrë pjesë në procesin e vendimmarrjes përcaktohet me Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit (Rreg. 2003/9). Ndonëse Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit nuk i referohet në mënyrë të drejtpërdrejtë parimit të pjesëzarrjes publike, në disa aspekte gjejmë mundësi praktike të inkorporimit të parimit të tillë. Për shembull, me rëndësi të veçantë për pjesëmarrjen e publikut është kërkesa për të publikuar procesin e vendimmarrjes gjatë VNM-së. Ligji përcakton se Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor përmes Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit duhet të publikojë çdo vendim paraprakisht për pëlqimin mjedisor në

<sup>23</sup> Direktiva 2001/42/EC (27 Qershor 2001) për vlerësimin e efekteve të disa planeve dhe programeve mjedisore është e arritshme në internet në [www.europa.eu.int](http://www.europa.eu.int)

një periudhë prej 30 ditësh nga data e shpalljes. Kjo ju mundëson qytetarëve rishqyrtimit të draft VNM-së dhe të ofrimit të mendimit dhe komenteve para marrjes së vendimit përfundimtar për VNM.

Një referim më përmbajtësor të parimit të pjesëmarrjes së publikut në procesin e vendimmarrjes përmban Ligji e Ujërave të Kosovës (Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2004/41). Ligji për Ujërat e Kosovës afirmon pjesëmarrjen publike sipas të cilës qytetarëve u jepet mundësi e mjaftueshme që të marrin pjesë në procesin e vendimmarrjes rreth menaxhimit të ujërave dhe resurseve ujore. Parimi i pjesëmarrjes publike është përfshirë në një kontekst më gjithëpërfshirës dhe të përgjithshëm në Ligjin për Ujërat e Kosovës në kuptim të një komunikimi më aktiv mes autoriteteve publike dhe qytetarëve në procesin e vendimmarrjes sa i përket menaxhimit të ujërave dhe resurseve ujore.

Po ashtu, ky Ligj siguron që dokumentet themelore për planifikimin dhe zhvillimin e menaxhimit ujor, po ashtu duhet t'i nënshtrohen diskutimeve publike.<sup>24</sup> Me përjashtim të planit për mbrojtje nga vërshimet, zhvillimi i Planit Strategjik të Ujërave, Plani për Menaxhimin e Ujërave dhe Plani për Menaxhimin e Pellgjeve Lumore kërkojnë përfshirje publike aktive para se të finalizohen. Ligji siguron që secili autoritet, i cili propozon planin, duhet të informojë publikun tri (3) vite para se të fillojë procesin e hartimit, duke siguruar kështu pjesëmarrje aktive dhe me kohë gjatë hartimit.<sup>25</sup> Para se të fillojë procesi i hartimit, autoritetet relevante duhet të sigurojnë që të gjitha palët relevante qeveritare nga qeveritë lokale dhe qendrore, organizatat jo-qeveritare, mbajtësit e të drejtave ujore si dhe palët tjera të interesuara kanë pasur mundësi të mjaftueshme për të kontribuar në përgatitjen e planit në fjalë. Pas përfundimit të hartimit, palët e involvuara do të kenë edhe një mundësi për të ofruar komentet e tyre mbi draftin e përgatitur në periudhë prej 6 muajsh nga data e shpalljes.<sup>26</sup>

<sup>24</sup> Ligji për Ujërat e Kosovës (Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2004/41), neni 64.

<sup>25</sup> Ibid., para. 2

<sup>26</sup> Ibid., para. 6

## V. QASJA NË DREJTËSI

### A. E drejta për t'ju drejtuar gjykatës

Aspekte të mbrojtjes gjyqësore të së drejtës për qasje në informacion dhe të drejtës për pjesëmarrje përcaktohet në Nenin 9 të Konventës. Në këtë drejtim, Konventa obligon Palët Kontraktuese që brenda kuadrit të legjislacionit kombëtar, të sigurojnë që çdo person i cili mendon se kërkesa e tij për informacion (sipas nenit 4) është “nënvleftësuar, refuzuar gabimisht, pjesërisht ose tërësisht, i është përgjigjur në mënyrë të pamjaftueshme” ose nuk është trajtuar në përputhje me rregullat e Konventës, të filloj një procedure shqyrtimi para një gjykate të pavarur dhe të paanshme të krijuar me ligj. Për më tepër, sipas Konventës, Palët duhet të parashikoj që një shqyrtim i tillë nga një gjykatë të zhvillohet pa vonesë, të jetë efektiv dhe i mbështetur në ligj. Vetëm duke iu drejtuar organeve të drejtësisë, vendimet e autoriteteve publike mund të vlerësohen nga pozicioni i një pale të tretë – gjykatat.<sup>27</sup> E drejta për t'ju drejtuar gjykatës, sipas Konventës, shtrihet edhe për korpusin e të drejtave që përcaktohen në Nenin 6 të Konventës – pjesëmarrja e publikut në proceset e vendimmarrjes për çështjet që kanë të bëjnë me mjedisin. Konventa përcakton se për të ngritur një çështje para gjykatës, personi duhet të ketë një interes të mjaftueshëm për çështjen ose i është cenuar ndonjë e drejtë individuale përcaktuar me Nenin 6 të Konventës. Se çfarë përbën një interes të mjaftueshëm dhe cenim të një të drejte, Konventa referon te kërkesat e legjislacionit kombëtar në mënyrë që publikut t'i jepen të drejta me të zgjeruara për t'ju drejtuar gjykatës për çështjet që kanë të bëjnë me qasjen në informacione apo pjesëmarrje të publikut në procesin e vendimmarrjes.

### B. Përgjegjësia penale për ndotjen e mjedisit

Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës (Rregullorja Nr. 2003/25), në Kapitullin XXIV përcakton veprat penale kundër mjedisit, kafshëve, bimëve dhe objekteve kulturore. Kodi Penal përcakton përgjegjësi penale për një numer veprimesh të cilat shkaktojnë dëme në mjedis dhe si të tilla tërheqin përgjegjësi penale. Neni 276 i Kodit Penal të Kosovës përcakton se “kushdo që duke e shkelur ligjin bën ndotjen ose degradimin e mjedisit apo shfrytëzon jashtë

mase burimet natyrore dhe me këtë shkakton rrezik për mjedisin dhe jetën a shëndetin e një numri të madh të njerëzve dënohet me burgim deri në dy vjet”. Nëse vepra penale (nga paragrafi 1 nenit 276) kryhet nga pakujdesia, “kryerësi dënohet me gjobë apo me burgim deri në një vit”. Nëse vepra penale (nga paragrafi 1 ose 2 i nenit 276 “rezulton me dëmtimin e shëndetit të një të numri të madh të njerëzve apo me asgjësimin e plotë ose të pjesërishtëm të botës shtazore, bimore ose të rezervave të ujit të pijshëm apo me ndonjë dëmtim tjetër të mjedisit me pasoja të rënda, apo me shtimin e nivelit të ndotjes në shkallë kritike ose në masë kritike apo dëmtimin kritik të mjedisit, kryerësi për veprën penale nga paragrafi 1 i këtij neni dënohet me burgim deri në pesë vjet, ndërsa për veprën penale nga paragrafi 2 i këtij neni dënohet me burgim deri në dy vjet”. Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës inkriminon edhe mbajtjen e paligjshme të substancave dhe mbeturinave të rrezikshme (Neni 277); veprimet e paligjshme me instalimet e rrezikshme (Neni 278); prodhimin, shitjen dhe vënien në qarkullim të materieve të dëmshme për mjekimin e shtazëve (Neni 279); ndotja e ushqimit dhe e ujit të shtazëve (Neni 282); shkatërrimi i botës bimore me mjete të dëmshme (Neni 283) dhe shkatërrimi i pyjeve (Neni 284).

<sup>27</sup> Shih [Ákos Kapitány](http://www.milieukontakt.nl), ‘Handouts Public Participation training’, ([www.milieukontakt.nl](http://www.milieukontakt.nl)).

## Shtojca 1

### Akte ndërkombëtare dhe ligje të cituara

1. Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike i Organizatës së Kombeve të Bashkuara
2. Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (1950)
3. Konventa për të drejtën e publikut për informacion, pjesëmarrje në vendimmarrje dhe të drejtën për t'ju drejtuar gjykatës, për çështje që lidhen me mjedisin – Konventa Aarhus (aprovuar më 1998)
4. Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit (Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2003/09)
5. Direktiva 2003/4/EC të Parlamentit Evropian dhe Këshillit (28 Janar 2003) mbi qasjen publike në informata mjedisore
6. Korniza Kushtetuese për Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë (2001)
7. Ligji për Ujërat (Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2004/41)
8. Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës (Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2003/25)
9. Direktiva 85/337 (27 Qershor 1985) për vlerësimin e efekteve mjedisore të disa projekteve private dhe publike
10. Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2001/36 mbi Shërbimin Civil në Kosovë
11. Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 32/2003 mbi Qasjen në Dokumente Zyrtare.

## Shtojca 2

### Aarhus Convention Secretariat

Palais des Nations, 8-14, avenue de la Paix - 1211 Geneva 10  
fax: 00 41 22 917 01 07  
E mail: [public.participation@unece.org](mailto:public.participation@unece.org)  
<http://www.unece.org/env/pp>

### Regional Environmental Center for Central and Eastern Europe

Ady Entre 9-11, 2000 Szentendre Hungary  
Tel: +36 26 504000  
Fax: +36 26 311294  
E mail: [info@rec.org](mailto:info@rec.org)  
[www.rec.org](http://www.rec.org)

### Qendra Rajonal e Mjedisit - REC

#### Zyra në Kosovë

Kodra e Diellit-Rruga 3, Lam.26 PO Box 160  
10000 Prishtina  
Tel./Fax. +381 38 552123  
E mail: [info@kos.rec.org](mailto:info@kos.rec.org)  
<http://kos.rec.org>

### Koalicioni i Kosovës për Konventën Aarhus

Kodra e Diellit-Rruga 3, Lam.26 PO Box 160  
10000 Prishtina  
Tel./Fax. +381 38 552123  
E mail: [info@sharri.net](mailto:info@sharri.net)  
[www.sharri.net/aarhus](http://www.sharri.net/aarhus)

## Shtojca 3

### Publikime të rëndësishme

1. Aarhus Convention: *The Implementation Guide, United Nations* (New York and Geneva: 2000)
2. Convention on Access to Information, Public Participation in Decision-making and Access to Justice in Environmental Matters. (The Stationery Office, 2005)
3. Developing and Implementing Integrated National Pollutant Release and Transfer Registers in the Accession Countries of Central and Eastern Europe (REC, 2003)
4. *Environmental Democracy in Practice*. Handbook for environmental and water management authorities on public participation. (REC, 2002)
5. Handbook on Access to Justice under the Aarhus Convention REC Hungary 2003
6. Peter G. Davies, *European Union Environmental Law*. (Ashgate Publishing: 2004)
7. Philippe Sands, *Principles of International Environmental Law*. (Cambridge University Press: 2003)
8. Public access to environmental information and data, practice examples from US, EU and Central and Eastern Europe (REC Hungary 2001)
9. Stacy D. (EDT) Vandevveer, *EU Enlargement and the Environment*. (Routledge: 2005)